

Çfarë është dhuna shtëpiake?

Dhuna shtëpiake është shkelja e përditëshme e të drejtave të njeriut dhe e shpërndarë më shumë në të gjithë botën. Kjo përfshin të gjitha format e dhunës në marrëdhëniet bashkëshortore/partneritetet ekzistuese dhe të ndara, por edhe në marrëdhëniet familjare ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve, të rriturve dhe të moshuarve si dhe njerëzve me aftësi të kufizuar (të pa aftë). Dhuna ndodh te të martuarit dhe të pamartuarit, si dhe në familje dhe njerëz që bashkëtojnë.

Dhuna konkretisht quhet:

- > kërcënim, ofendim, sharje, frikësim
- > hedhje me sende, shtyrje, tundje, shpullat, kafshim, mbytyje, shkelje me këmbë, grushta,
- > përdorim arme
- > detyrim për veprime seksuale
- > kontroll dhe ndalim i kontakteve familjare si dhe kontakteve me të huaj
- > mbylje në shtëpi
- > mos dhënje e parave për buxhetin e shtëpisë
- > përgjim mbas ndarjes, përndjekje, gjurmim (Stalking)
- > shqetësim (me telefon, me e-mail etj.)
- > detyrim për martesë (të rinjtë dhe adoleshentët)

Kush preket nga dhuna?

Veçanërisht femrat janë viktimat e dhunës shtëpiake. Në Zvicër çdo femër e pestë

përjeton dhunë nga partneri/bashkëshorti. Por edhe meshkujt mund të jenë viktimat e dhunës shtëpiake.

Shumë fëmijë dhe të rinj vuajnë nga dhuna shtëpiake në familjet e tyre dhe rritja e tyre e shëndoshë është në rrezik. Dhuna shtëpiake ndodh në çdo shtet dhe klase të edukimit, ekziston në çdo moshë, kombësi, feje dhe kulture.

Dhuna shtëpiake ka pasojat

Marrëdhëniet me dhunë zgjaten shumë dhe të prekurit kanë vështirë të kërkojnë ndihmë. Shumë të prekur ndjehen vetëm, kanë turp për situatën e tyre dhe frikë nga përdorimi i dhunës në vazhdimësi. Dhënja e fjalës që të hiqet dorë nga përdorimi i dhunës shpesh nuk mbahet. Dhuna shtëpiake shpesh herë ka pasoja të shumëllojshme dhe të rënda për viktimat, dhe dëmton shëndetin e të prekurve si dhe gjëndjen shpirtërore.

Çfarë mund të bëj unë, nëse jam prekur nga dhuna shtëpiake?

Dhuna shtëpiake në Zvicër është e ndaluar dhe penalizohet. Ju mund të mbroheni:

- > Kërkoni përkrahje dhe ndihmë tek zyrat këshillimore.
- Këto ju informojnë dhe ju japin këshillë për pyetjet personale dhe juridike.
- Informacioni është falas dhe sekret.
- > Në qoftë se nuk ndjeheni të sigurtë

- në shtëpinë tuaj, atëherë keni të drejtën – bashkë me fëmijët tuaj – të largoheni nga shtëpia.
- Shtëpitë për gratë dhe institucionet e tjerë përkohësisht ju japin mbrojtje dhe këshillët.
- > Në rast urgjence telefononi policinë në tel 117.

Çfarë ndodh kur vjen policia?

Policia në radhë të parë do të ndalojë dhunën dhe të sigurojë armët ekzistuese. Ajo do të nisë hetimet dhe vendos masat për mbrojtjen sipas nevojës:

- > Ajo mund të largojë personin i cili ushtron dhunë ose kërcënon me dhunë, për disa ditë nga shtëpia dhe mund ti ndalojë atji kthimin në shtëpi (largim).
- > Ajo mund të arrestojë personin i cili ushtron dhunë dhe mund të urdhërojë largimin më vonë.
- > Ajo lajmëron në vend njerëzit përkatës (viktimën dhe personin i cili ushtron dhunën) për të drejtat e tyre dhe për vendet ku merren këshillat.

Çfarë mund të bëj unë, nëse unë vet ushtroj dhunë?

Dhuna penalizohet dhe sjell dëm – tek ju vetë si dhe tek të afërmit tuaj. Ju mund të bëni diçka kundër:

- > Kërkoni ndihmë dhe përkrahje tek një

- këshillimore e specializuar ose tek mjeku/mjekja i/e shtëpisë.
- > Flisni me një person të afërt për ndjenjat tuaja.

Çfarë mund të bëj unë, nëse marr vesh që në fqinjësinë time ushtrohet dhunë?

Duhet guxim që të përziheni me çështjet private të njerëzve të tjerë. Mëgjithatë ka rëndësi që të reagoni.

- > Në rast urgjence lajmëroni policinë në tel 117
- > Mos vini vetën tuaj në rrezik duke ndërhyrë vet.
- > flisni me personin e prekur nga dhuna kur e takoni vetëm. Tregoni që keni mirëkuptim dhe ngushëllim, mëshirë. Lajmëroni atë që në Zvicër ekzistojnë oferta për ndihmë dhe që dhuna shtëpiake është e ndaluar me ligj.
- > Kërkoni vet këshilla dhe përkrahje tek këshillimorët.

Polizeinotruf 117
Urgjenca e policisë
në dispozicion 24 orë

Sanitätsnotruf 144
Urgjenca mjeksore është
në dispozicion 24 orë

Frauenhaus
Shtëpia e grave
041 360 70 00
në dispozicion 24 orë
www.frauenhaus-luzern.ch

Opferberatungsstelle
Këshillimore për viktimat

Luzern 041 227 40 60
www.disg.lu.ch/opferberatung

Nidwalden 041 618 44 82
www.nw.ch

Obwalden 041 666 64 62
www.ow.ch

Schwyz/Uri 0848 82 12 82
www.sz.ch, www.ur.ch
www.arth-online.ch/opferhilfe

Zug
041 725 26 50 www.eff-zett.ch
041 728 80 80
www.triangel-zug.ch

Jugendberatungsstellen
Këshillimore për të rinjtë
www.no-zoff.ch, www.tschau.ch

Pro Juventute 147
Për të rinjtë
Ndihmë për fëmijë dhe të rinjtë, www.147.ch

Die Dargebotene Hand 143
Dora miqësore
në dispozicion 24 orë
www.143.ch

agredis.ch
078 744 88 88
Këshillimore për meshkujt të cilët ushtrojnë dhunë

Vollzugs- und Bewährungsdienste des Kantons Luzern
Shërbim i ekzekutimit dhe ruajtje
041 228 59 66
Këshillimore për femrat të cilat ushtrojnë dhunë

FABIA
041 360 07 22
Këshillim dhe integrim i të huajve

ose drejtohuni shërbimit social i komunës së vëndbanimit tuaj.